REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Ministrja Xhaçka jep lajmin e shumëpritur: Marrëveshja për njohjen e patentave botohet në Fletoren Zyrtare

2021-03-30 10:17:00



Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, bëri me dije se marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të patentave mes Shqipërisë dhe Italisë është botuar në Fletoren Zyrtare.
Ministrja Xhaçka ka publikuar në rrjetet sociale dokumentin e publikuar në Fletoren Zyrtare, duke theksuar se tashmë pritet ratifikimi nga autoritetet italiane, për të nisur shumë shpejt zbatimin.
Kjo marrëveshje u dakordësua gjatë vizitës së Ministres Xhaçka në Itali më 12 mars, ndërsa më 18 mars ajo u firmos në Tiranë mes Kryediplomates Xhaçka dhe ambasadorit italian në Shqipëri, Fabrizio Bucci.